



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

ALEANCA E GRAVE DEPUTETE

RAPORT

PËR VEPRIMTARINË E GRUPIT TË DEPUTETËVE “ALEANCA E GRAVE DEPUTETE” PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2019

I. ORGANIZIMI I ALEANCËS SË GRAVE DEPUTETE (AGD)

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënese të të gjitha grupimeve politike në Kuvendin e Shqipërisë. Aleanca e Grave Deputete ka në vëmendje të saj arritjen e objektivit që synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor minimalisht me 40% brenda 10 viteve.

Njohja dhe respektimi i të drejtave politike për shtetasit në tërësi, duke mos përjashtuar gratë, qëndron në themel të demokracisë. Këto të drejta mbrohen nga ligjet themeltare të një shteti, që janë kushtetutat e çdo vendi. Duke realizuar qëllimin e barazisë së gruas dhe burrit në vendimmarrje, sigurohet ajo balancë, e cila reflekton përbërjen e shoqërisë dhe forcimin e demokracisë, si dhe nxit një funksionim më të mirë të shoqërisë. Në këtë kuptim barazia në pjesëmarrje në jetën politike, luan një rol kryesor në procesin e përparimit të rolit të gruas në shoqëri. Pa pjesëmarrjen aktive dhe përfshirjen perspektive të saj në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, qëllimet e barazisë, të zhvillimit dhe paqes nuk mund të arrihen.

Aleanca e Grave Deputete për legjislaturën e IX, përbëhet nga gratë deputete të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste, Grupi “Demokrat”, Grupi “I pavarur”, Grupi “Demokraci dhe drejtësi” dhe gra deputete të pavarura. Aktualisht, Aleanca e Grave Deputete përbëhet nga 36 gra. (*Shtojca nr. 1*)



Foto e Aleancës së Grave Deputete pas rikonstituimit të saj.

II. VEPRIMTARIA E AGD-SË GJATË VITIT 2019

Aleanca e Grave Deputete gjatë vitit 2019 ka kryer aktivitetet e mëposhtme:

Më datë 4 shkurt 2019, gratë deputete të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në kuadër të javës së Parandalimit të Kancerit të Qafës së Mitrës dhe Ditës Botërore kundër Kancerit me të ftuar nga institucionet ekzekutive qendrore dhe ato të pavarura, shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Përveç deputetëve të komisionit në seancë dëgjimore morën pjesë edhe anëtarët e Aleancës së Grave Deputete dhe anëtarët e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas si dhe znj. Ogerta Manastarliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësues nga shërbimi onkologjik në QSUT, nga spitalet rajonale, nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, si dhe Qendra e kujdesit paliativ “MARY POTTER”, Korçë; Universiteti i Mjekësisë; Qendra për Popullsinë dhe Zhvillimin; UNFPA Shqipëri (Fondi Popullor i Kombeve të Bashkuara; Koalicioni për shëndetin e gruas; Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA of Albania).

Më datë 8 shkurt 2019, Rrjeti i Grave Barazi në Vendimmarrje në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Demokraci (NDI) dhe mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, në konsultim me gratë deputete, me mbështetjen e Nënkomisionit Parlamentar për Barazi Gjinore dhe Aleancën e Grave Deputete, organizuan sesionin e parë të Akademisë së Lidërsip-it me temë “*Komunikimi dhe e Folura në Publik*” nën drejtimin e zonjës Jen Krimm, eksperte amerikane në fushën e komunikimit politik.

Akademia do të shërbejë për një kontribut sa më efektiv të ligjvënësive, për t’u përgjigjur nevojave të tyre të përditshme si ligjvënëse dhe për të garantuar një performancë efektive të detyrës së tyre dhe për t’u bërë modele për gratë dhe vajzat, të cilat dëshirojnë të angazhohen në jetën politike.

Sesioni i parë trajtoi tre çështje: a) e folura për çështje komplekse (politika, legjislacion etj.) për audienca të ndryshme dhe zhvillimi i mesazheve; b) e folura në situata sfiduese, në opozitë, dhe në audienca jo miqësore; forcimi i karizmës dhe prezencës; menaxhimi i sulmeve dhe çështjeve të papritura; etj; c) e folura në media, intervista, marrëdhënia me medien etj.

Akademia e Lidërsip-it do të zhvillohet bazuar në 5 tema dhe module që konsiderohen të rëndësishme për ligjvënëset në punën e tyre si komunikimi; teknikat legjislative; lidërsipi; buxhetimi i përgjegjshëm gjinor; ngritja e fondeve dhe aksesit në financimin e partive politike.

Në përfundim të pjesës teorike të “Akademisë së Lidërsipit – Executive Masterclass – Legjislatura IX” në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e vendeve të ndryshme në Shqipëri, ligjvënëset pjesëmarrëse do të ftohen të marrin pjesë në vizita studimore

në vende të ndryshme të botës, të cilat kanë eksperiencë pozitive në lidhje me fushat e trajtuara gjatë Akademisë.

Më datë 12 shkurt 2019, gratë deputete të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 10.237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, me fokus veprimtaritë e industrisë fasone në vendin tonë.

Më datë 19 shkurt 2019, ish – kryetarja e AGD-së znj. Dhurata Çupi, mori pjesë në workshopin e zhvilluar nga Women’s Democracy Network, gjatë të cilit u diskutuan çështje lidhur me reformën zgjedhore dhe amendimet e kodit zgjedhor për zgjedhjet e 2019 si dhe fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në zgjedhjet vendore.

Më datë 8 mars 2019, u mbajt sesi i XI i Parlamentit të Grave të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ky sesi u mbajt në parlamentin e Malit të Zi gjatë të cilit gratë shkëmbyen përvojat dhe angazhimet e parlamenteve të tyre në lidhje me barazinë gjinore në procesin e integritimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Të pranishme në këtë aktivitet ishin Zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi dhe znj. Senida Mesi, deputete dhe zëvendëskryetare e Komisionit për Integrimin Evropian.

Më datë 20 mars 2019, gratë deputete të Aleancës së Grave Deputete morën pjesë në workshopin me temë: “Legjislacioni me ndjeshmëri gjinore për Kuvendin e Shqipërisë”, i organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në bashkëpunim me OSBE/ODIHR. Çështjet që u diskutuan gjatë workshopit, ishin mbi legjislacionin me ndjeshmëri gjinore, në praktikë, si edhe parimet për zbatimin e tij, standarde ndërkombëtare dhe praktika të ndryshme për barazinë gjinore dhe parlamentet me ndjeshmëri gjinore, institucionalizimi i legjislacionit me ndjeshmëri gjinore, në Shqipëri etj. Gjithashtu, në përfundim të workshopit u prezantua dhe një plan për të ardhmen, hapat që do ndërmerren më tej, fokusi kryesor, si edhe analiza gjithëpërfshirëse me bazë gjinore, si komponenti thelbësor i Legjislacionit me Ndjeshmëri Gjinore.

Më datë 7 maj 2019, gratë deputetë pjesë e AGD-së morën pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas në lidhje me romët.

Më datë 5 maj 2019, Aleanca e Grave Deputete, nën drejtimin e nënkryetares znj. Elona Gjebrea Hoxha, zhvilloi mbledhje për të prezantuar punën e kryer gjatë vitit 2018 dhe për të prezantuar kalendarin e aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë dy viteve të ardhshme. Të pranishme në mbledhje ishin gratë deputete të të gjitha forcave politike, përfaqësues nga organizata ndërkombëtare OSBE dhe UN Women dhe staf mbështetës i Kuvendit. Gjithashtu, gjatë kësaj mbledhje u zgjodh kryetarja e re e AGD-së znj. Fatjona Dhimitri dhe sekretare znj. Aurora Mara. Ndërkohë që nënkryetare është znj. Elona Gjebrea Hoxha. Gjithashtu gjatë kësaj mbledhje të

Aleancës u miratua dhe u diskutua dhe një kalendar me aktivitete që do të zhvillohen nga AGD-ja.

Më datë 26-27 qershor 2019, në Shkup u zhvillua një konferencë rajonale me temë “Parlamentet me ndjeshmëri gjinore: Nga legjislacioni deri tek financimi publik për barazinë gjinore”. Në këtë konferencë morën pjesë znj. Elona Gjebrea, znj. Fatjona Dhimitri. Në fokus të kësaj konference ishte prezantimi i standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të mira lidhur me parlamentet me ndjeshmëri gjinore. Gjithashtu, u prezantuan dhe diskutuan disa nga praktikat më të mira nga rajoni. Gjatë kësaj konference u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit rajonal si dhe për financimin publik për barazi gjinore si dhe u prezantua sondazhi i kryer nga OSBE mbi dhunën ndaj grave në Evropën Juglindore – gjetjet dhe rekomandimet kryesore.

Më datë 18 -19 tetor 2019, një seminar dypalësh me temë “Drejt parlamenteve me ndjeshmëri gjinore”, me pjesëmarrjen e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, si dhe të stafëve të tyre mbështetëse, u zhvillua në Pogradec.

Gjatë këtyre dy ditëve, pjesëmarrësit ndan përvojat e tyre mbi gjendjen aktuale dhe prezantuan hapat e marra për vendosjen e praktikave më të mira të punës me ndjeshmëri gjinore si edhe diskutuan për institucionalizimin e ndjeshmërisë gjinore në parlamente. Gjithashtu gjatë këtij seminari u prezantuan praktikat më të mira ndërkombëtare në Slloveni, Suedi dhe në Finlandë.

Gjatë seminareve paralele, pjesëmarrësit nga Shqipëria përfunduan rishikimin e praktikave dhe politikave ekzistuese mbi ndjeshmërinë gjinore dhe nisën programimin për të ardhmen, si dhe përgatitjen e një roadmap-i dhe integrimin e tij në Planin Strategjik të Kuvendit të Shqipërisë. Ndërsa përfaqësuesit e Maqedonisë së Veriut hartuan një plan aktiviteteve mbi ndjeshmërinë gjinore për periudhën 2019 – 2020.

Ky seminar u organizua me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Tiranë dhe Misionin e OSBE-së në Shkup. Seminari është pjesë e projektit “Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri” i cili zbatohet nga Prezenca e OSBE-së .

Më datë 26.10.2019 ,u zhvillua në Tiranë, konferenca rajonale “ *Women’s empowerment for a peaceful Balkans and European Future*” nga Regional Women’s Lobby in Southeast Europe. Qëllimi i kësaj konference ishte forcimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje, ndërtimi i paqes dhe integrimi evropian. Përmes diskutimit intensiv gratë shprehën shqetësime për paqen dhe sigurinë e brishtë në Ballkanin Perëndimor, i cili vazhdon të kërcënohet nga institucionet e dobëta demokratike, sundimi i ligjit, korrupsioni, rritja e ulët ekonomike, ndarja etnike dhe mosbesimi.

Gratë bënë thirrje për barazi gjinore dhe fuqizim më të madh të grave për të siguruar Ballkanin e Paqes dhe Ardhmërinë Evropiane. Gratë bënë thirrje gjithashtu për proceset e paqes për të integruar marrëveshjet gjinore gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjen e nevojshme të grave në tryezat e bisedimeve, me fokus të veçantë në dialogun e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Konsiderimi i kapitalit njerëzor strategjik që gratë sjell në shoqëri, fuqizimi i grave është një përgjigje strategjike për adresimin e sfidave aktuale, përshpejtimin e zhvillimit, demokracinë, stabilitetin dhe parandalimin e fenomeneve të migrimit të rinjve për të gjetur një të ardhme në vendet e treta. Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu për mënyrat e rritjes së aksesit në drejtësi për gratë për hir të shoqërisë gjithëpërfshirëse, drejtësisë kalimtare dhe drejtësisë ndërkombëtare për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin.

Gjatë muajit tetor, Aleanca e Grave Deputete, në kuadër të “Tetorit Rozë” gjatë gjithë muajit organizoi takime sensibilizuese në disa qytete të vendit, për të gjitha gratë dhe vajzat me kryefjalë bërjen e kontrollove periodike, për të luftuar në kohë këtë sëmundje.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, gjatë këtyre takimeve është mundësuar kryerja e kontrollit për gratë dhe vajzat nëpërmjet një kalendari paraprak me mamografë të lëvizshëm. Gjatë takimeve sensibilizuese gratë deputete kanë bashkuar zërin për të rritur ndërgjegjësimin tek çdo grua dhe vajzë për të bërë kontrollin e gjirit, për të gjetur guximin për t’u përballur me sëmundjen e vështirë, sepse lufta kundër kancerit të gjirit mund të fitohet, prandaj kontrolli periodik dhe diagnostikimi i hershëm janë shumë të rëndësishëm për jetën dhe shëndetin e të gjitha grave.

Në vijim të këtyre aktiviteteve sensibilizuese, gratë deputete pjesë e Aleancës, më datë 22 tetor 2019, morën pjesë në koncertin e bamirësisë të organizuar nga sopranoja Ermonela Jaho nën kauzën “Fjongo rozë”.

Më datë 5 nëntor 2019, disa përfaqësuese të AGD-së morën pjesë në takimin konsultativ të organizuar nga UNFPA Albania dhe Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave me temë “Ndryshimet demografike dhe pabarazitë gjinore në Shqipëri - nga Kajro 1994 dhe më tej: Arritjet dhe pengesat. Ky takim është pjesë e një serie rishikimesh dhe konsultimesh me palët dhe partnerët kombëtare të interesuar për çështje që janë aktuale, jetike dhe të domosdoshme për të marrë vëmendjen e hartuesve të politikave, partnerëve kombëtarë, OSHC-ve, partnerëve të zhvillimit, akademisë, institucioneve mbikëqyrëse përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut.

Ky rishikim do t’i hapë rrugën Samitit në Nairobi mbi ICPD + 25 që do të mbahet në Kenia, 12-14 Nëntor 2019, ku delegacionet kombëtare, do të sjellin me vete angazhimet që rrjedhin nga këto konsultime në mbështetje të Programit të Veprimit të ICPD.

Më datë 7 nëntor 2019, disa përfaqësuese të AGD-së morën pjesë në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore ku prezantuan disa nga sugjerimet e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave. Nënkyetarja e AGD-së, znj. Elona Gjebrea Hoxha prezantoi disa sugjerime lidhur me draftin e ekspertëve për Reformën Zgjedhore:

- a) pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në administrimin zgjedhor;
- b) respektimi i dispozitave për kuotën gjinore dhe dënimi jo vetëm me gjobë por edhe me një masë tjetër në formën e refuzimit;
- c) për sa i përket renditjes së kandidatëve, barazia gjinore mund të faktorizohet apo avantazhohet në renditjen e kandidatëve, qoftë në rrafsh horizontal apo vertikal. Kjo mund të bëhet jo vetëm në zgjedhjet kombëtare, por edhe në ato vendore.

Më datë 12 – 14 nëntor 2019, u zhvillua në Nairobi, Samiti mbi ICPD + 25, një konferencë e nivelit të lartë që synon të mobilizojë vullnetin politik dhe angazhimet financiare të nevojshme për zbatimin e Programit të Veprimit të ICPD.

Në këtë Samit, morën pjesë nënkryetarja e Aleancës së Grave Deputete znj. Elona Gjebrea, znj. Eglantina Gjermeni dhe znj. Klodiana Spahiu.

Samiti trajtoi nxori në pah fuqinë e barazisë gjinore, udhëheqjen e të rinjve, udhëheqjen politike dhe të komunitetit, inovacionin dhe të dhënat dhe partneritetet për të përshpejtuar përparimin në të gjithë.

Mbështetja e të drejtës për kujdes shëndetësor seksual dhe riprodhues edhe në kontekste humanitare dhe të brishtë. Samiti i Nairobi do të sigurojë një platformë për qeveritë dhe organizatat e tjera për të shpallur angazhime vullnetare, globale që do të përshpejtojnë përparimin.

Më datë 15 nëntor 2019, gratë pjesë e AGD-së morën pjesë në Forumin Rajonal të Barazisë Gjinore të organizuar nga Rrjeti “Barazi në Vendimmarrje”, me mbështetjen e National Endowment for Democracy, në kuadër të punës për nxitjen e barazisë gjinore në Shqipëri. Forumi i Barazisë Gjinore 2019, synon të jetë një burim frymëzimi dhe mbështetjeje që lidh dhe fuqizon gratë dhe burrat së bashku, për të kapërcyer hendekun gjinor në Shqipëri, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mundësive të barabarta, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në vendimmarrje. Forumi i Barazisë Gjinore 2019, synon të ofrojë një platformë kombëtare për të diskutuar përgjegjësitë tona kolektive dhe për të eksploruar rrugët më efektive drejt barazisë gjinore.

Më datë 2 dhjetor 2019, përfaqësueset e AGD-së morën pjesë në seancën dëgjimore të organizuar nga Nënkomisioni Parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave. Në vëmendje të kësaj seance dëgjimore ishin diskutimet për “Buxhetimin gjinor 2020” me pjesëmarrjen e Ministres së Shëndetësisë. Anëtarët e këtij nënkomisioni, duke vlerësuar ndjeshmërinë e çështjeve të barazisë gjinore, në përgjithësi, si dhe problematikën e buxhetimit gjinor, në veçanti, organizuan këtë takim me Ministrën e Shëndetësisë, përfaqësues të Ministrisë

se Financave, përfaqësues të shoqërisë civile në lidhje me buxhetimin gjinor të projektligjit “Për buxhetin 2020”.

Shtojca 1

<i>EMRI, MBIEMRI</i>	<i>GRUPI PARLAMENTAR</i>
<i>Ermonela Valikaj (Felaj), Eglantina Gjermeni, Vasilika Hysi, Elisa Spiropali, Vilma Bello, Klodiana Spahiu, Lindita Nikolla, Klotilda Bushka (Ferhati), Milva Ekonomi, Senida Mesi, Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Almira Xhembulla, Mirela Kumbaro (Furxhi), Edlira Bode, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Olta Xhaçka, Ogerta Manastirliu, Tatiana Piro (Nurçe), Adelina Rista, Evis Kushi, Ardiana Jaku, Artemis Malo.</i>	<i>Grupi parlamentar i Partisë Socialiste</i>
<i>Rudina Hajdari, Fatjona Dhimitri.</i>	<i>Grupi parlamentar “Demokrat”</i>
<i>Amra Barova, Aurora Mara, Ediola Braha, Enada Kapllani, Edlira Hyseni.</i>	<i>Grupi parlamentar “I pavarur”</i>
<i>Majlinda Halilaj.</i>	<i>Grupi parlamentar “Demokraci dhe drejtësi”</i>
<i>Reme Lala, Elena Xhina, Elda Hoti, Suzana Topi.</i>	<i>Jashtë grupeve parlamentare</i>